

STATUT I NJË SHOQËRIE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më **17/12/2020**, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **COMMODO ACCOMODATION SH.P.K.**
2. Themeluesit e shoqërisë janë (*mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit*):
 - a. **Alket Bullati**, Lindur në Fier dhe banues në Fier, identifikuar me letërnjoftim ne numër dhe numër personal (**ID**) **H41028009S**
 - b. **Devid Shakohoxha**, Lindur në Tirane, dhe banues ne Tirane,identifikuar me letërnjoftim ne numër dhe numër personal (**ID**) **J90807052N**
 - c. **Kreshnik Gjoleka** Lindur në Fier, dhe banues ne Tirane,identifikuar me letërnjoftim ne numër dhe numër personal (**ID**) **I10623018G**

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Organizim, negocim , rezervim dhe konsulencë per ambjente akomoduese per persona apo kompani.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë:

- Për një afat të pacaktuar



The image shows three handwritten signatures in blue ink. From left to right: 1. A signature that appears to be 'Alket Bullati'. 2. A signature that appears to be 'Devid Shakohoxha'. 3. A signature that appears to be 'Kreshnik Gjoleka'. Below the third signature is a small number '1'.

Neni 4:

Selia

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Njësia Bashkiake Nr. 5, Rr. Osman Myderizi, Nd 2 H3 Ap29, Tiranë, Shqipëri.**
- (2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronike është si vijon: info@commodo.group
- (3) Numri i telefonit të shoqërisë për qëllime komunikimi telefonik është si vijon:
+355 67 401 9141 : +44 7853 389626 : +355 69 326 2898

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar filletar i Shoqërisë është **100.00 Lekë**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- (1) **Alket Bullati** zotëruar i 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme **45 lekë** që përben **45% të kapitalit themeltar** të shoqërisë.
- (2) **Devid Shakohoxha**, zotëruar i 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme **45 lekë** që përben **45 % të kapitalit themeltar** të shoqërisë.
- (3) **Kreshnik Gjoleka** zotëruar i 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme **10 lekë** që përben **10 % të kapitalit themeltar** të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

2

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- (1) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- (2) shitblerjes;
- (3) trashëgimisë;
- (4) dhurimit;
- (5) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organı Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- (1) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- (2) ndryshimet e statutit;
- (3) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- (4) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- (5) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- (6) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- (7) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- (8) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- (9) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- (10) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- (11) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuromi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.



Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vndos me tri të katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vndos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit dhe specimenët e nënshkrimit:

Emri	ID	Kontakt
Kreshnik Gjoleka	I10623018G	+355 67 401 9141

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

1. Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. Kujdeset përmes mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. Përgatit dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
5. Krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmiratim;
7. Raportojë përrpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratim;
8. Kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori eshte ti detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

1. Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
2. Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përmiratim, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. -shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përmiratim, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Transaksionet Bankare

- Menjëherë pas themelimit dhe regjistrimit në QKR Shoqëria do të çelë llogari bankare në njëren ose disa nga bankat e nivelistët që e sheh të nevojshme.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare, administratori detyrohet:

- Të Posacme:
 - të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - u kthen ortakëve kontributet;
 - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - u shpërndan aktivet shoqërisë;



- d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkuesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR, EKSPERTËT

Neni 17

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtmisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 18

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V


Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 19

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- kur mbaron kohëzgjata e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim të Asamblesë së Ortakëve;



- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtarë për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”. Prishja e Shoqërive tregëtarë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi, ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 21

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqipëtar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit Për tregtarët dhe Shoqëritë tregëtarë, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do te jetë kompetente Gjykata Shqipëtare.



Nënshkrimi

ORTAKËT E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
COMMODO ACCOMODATION SH.P.K

Alket Bullati

Devid Shakohoxha

Kreshnik Gjoleka

Alket Bullati


Devid Shakohoxha


Kreshnik Gjoleka
